

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT PERELTO STONE QUARRY sh.p.k.

Në bazë të Legjislacionit Shqiptar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, ne

Taulant Metohu, atësia Nebi, me shtetësi Shqiptare, lindur në Donofrosë dhe banues ne Kucovë, Postbllok, 00190094, ndërtesa 7, hyrja e parë, Perondi 5306, Kuçovë, i datëlindjes 19.01.1987, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit personal të identifikimit kartë identiteti nr. 037069372 dhe nr. Personal I70119007K.

dhe

Dashnor Byci, atësia Besim, me shtetësi Kosovare, lindur në Gjakovë, Kosovë, dhe banues ne Hencve 04060064; Nd. 166; H.1, Golem; Qerret; 2504; Kavajë, i datëlindjes 14.06.1976, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit leje qëndrimi nr. 839698698 dhe nr. Personal H63614003Q, lëshuar nga DVKM Durrës më datë 22.10.2024, e vlefshme deri më datë 22.10.2029.

dhe

Ujkan Byci, atësia Besim, me shtetësi Kosovare, lindur në Gjakovë, Kosovë, dhe banues në Prishtinë, Kosovë, i datëlindjes 20.05.1982, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit personal të identifikimit kartë identiteti nr. ID1998382 dhe nr. Personal 1001473618, lëshuar nga Republika e Kosovës më datë 08.12.2021, e vlefshme deri më datë 07.12.2031.

dhe

Fatmir Hakaj, atësia Sali, me shtetësi Kosovare, lindur në Deçan, Kosovë dhe banues në Osekë Hilë, Gjakovë, i datëlindjes 04.01.1986, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit personal të identifikimit kartë identiteti nr. ID0767689 dhe nr. Personal 1500931775, lëshuar nga Republika e Kosovës më datë 23.06.2017, e vlefshme deri më datë 22.06.2027.

dhe

Faton Hakaj, atësia Sali, me shtetësi Kosovare, lindur në Deçan, Kosovë dhe banues në Prishtinë, i datëlindjes 25.03.1988, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit personal të identifikimit kartë identiteti nr. ID0866869 dhe nr. Personal 1173683550, lëshuar nga Republika e Kosovës më datë 07.11.2017, e vlefshme deri më datë 06.11.2027.

Shpallim si më poshtë vijon:

Sot, më datë 19.02.2025 (njëzet e pesë) në Berat, krijimin e shoqërisë **PERELTO Stone Quarry sh.p.k.**

KAPITULLI I EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

Neni 1

Emri

1.1 Shoqëria do të quhet **PERELTO Stone Quarry sh.p.k.** (Këtu e më poshtë “Shoqëria”)

1.2 Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Selia

Selia e shoqërisë do të jetë në: Fshati Bistovicë, Zona kadastrale nr.376/2, me numer pasurie 2654,Ura Vajgurore, Berat.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat.

Neni 4
Objekti

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Nxjerrja, prodhimi, përpunimi, tregtimi i Mermerit, Granitit dhe të gjithë gurëve natyralë dhe materialeve të tjera të ndërtimit. Tregtimi i artikujve të ndryshëm, import-eksport.

KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR
NENI 5 - Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 30,000 (tridhjetëmijë) lekë i përbërë nga 5 kuota.

1. **Z. Taulant Metohu**, zotëron 1 kuotë = 30 % të kapitalit të shoqërisë, në vlerë 9,000 (nëntëmijë Lekë),
2. **Z. Dashnor Byci** , zotëron 1 kuotë = 20 % të kapitalit të shoqërisë, në vlerë 6,000 (gjashtëmijë Lekë),
3. **Z. Ujkan Byci** zotëron 1 kuotë = 20 % të kapitalit të shoqërisë, në vlerë 6,000 (gjashtëmijë Lekë),
4. **Z. Fatmir Hakaj** zotëron 1 kuotë = 15 % të kapitalit të shoqërisë, në vlerë 4,500 (katërmijepesëqind Lekë) dhe
5. **Z. Faton Hakaj** zotëron 1 kuotë = 15 % të kapitalit të shoqërisë, në vlerë 4,500 (katërmijepesëqind Lekë).

5.2 Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve themelues.

5.3 Kuota e Pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emëruara dhe të pa ndashme. Kapitali është terësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Çdo kuotë i takon e drejta e një vote.

NENI 6 – Organet Drejtuese

6.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj të cilat janë:

1. Asambleja e përgjithshme
2. Administratori

6.2 Ortaku që ka ndërmend të shesë kuotat e tij tërësisht, apo pjesërisht duhet më parë të njoftojë ortakët e tjerë të shoqërisë. Ortaku tjetër ka të drejtën e blerjes së parë. Këtë të drejtë ortaku duhet ta ushtrojë brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit.

6.3 Në rastin e mos ushtrimit të së drejtës së blerjes së parë, ortaku që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të afuara ortaku tjetër të shoqërisë.

NENI 7

Kuotat e kapitalit janë të pasqyruara dhe të regjistruara në librat e llogarisë të shoqërisë.

NENI 8

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortaku nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar në ligj.

NENI 9

Shoqëria tregtare “PERELTO Stone Quarry” sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, material ose jo material, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurive së vet tek të tjerët.

NENI 10

Shoqëria tregtare “PERELTO Stone Quarry” sh.p.k. vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku/et themelues i shoqërisë, mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kuotave të kapitalit të investuar në të. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që ortaku/et ka pasur para se ajo të krijohet.

KAPITULLI I III DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 11 - Kompetencat e ortakut

- 11.1 Ka të drejtë të administrojë aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund të kryejë, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Ka të drejtë të marrë dijeni për rezultatet ekonomiko-financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj. Ka të drejtë të marrë pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesve në këtë aktivitet.
- 11.2 Ka të drejtë të tërheqë të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë për tre vitet e fundit.
- 11.3 Ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria dhe mund të shesë pjesën e kapitalit të tij në përputhje me kushtet që i lejon statuti dhe ligji.
- 11.4 Ortaku në përputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin në fuqi, ka të drejtë që në të njëjtën kohë të jetë ortak edhe në shoqëri të tjera.
- 11.5 Ortaku rezervon të gjitha të drejtat sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 12

Shoqëria do të drejtohet nga Administratori i saj z. Taulant Metohu.

NENI 13 - Administrimi i shoqërisë

- 13.1 Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, me qëllim që të arrijë objektivat e saj, përveç atyre që ligji ia atribuon ortakëve.
- 13.2 Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretet si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.
- 13.3. Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të treteve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për detyra të kryera gjatë administrimit. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi ndaj administratorit.
- 13.4 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut, ka të drejtë të veprojë, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

- 13.5 Shoqëria administrohet te paktën 1(një) dhe maksimumi 3(tre) administratore, te cilet qendrojnë ne detyre deri ne revokimin apo doreheqjen per nje periudhe maksimale prej (5 vite).

NENI 14 - Detyrat e Administratorit/ëve

14.1 Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe te drejta:

- a. Të mirë administrojë pasurinë e shoqërisë.
- b. Të lidhë marrëveshje me të tretët brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortaket.
- c. Te zbatoje rregullat e brendshme te shoqërisë.
- d. Te paguhet per punen e kryer ne baze te marrëveshjes se bere midis tij dhe ortakeve.
- e. Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithcka qe ai e quan te dobishme per shoqërinë.
- f. Te miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe ti paraqesë ato sipas rastit për miratimin përfundimtar nga ortakët.
- g. Te behen propozimet perkatese asamblese se se ortakeve kur lind nevoja per ndryshime ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- h. Te miratoje aktet normative qe percaktojnë raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire personelin.
- i. Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise dhe te krijoje organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektive te shoqerise.
- j. Ti propozoje ortakeve per krijimin e njesive strukturave te ndryshme si filial, dege e përfaqësi ne qytetet te tjera te vendit ose jashte shtetit.
- k. Te përgatise propozimin për pushimin e veprimtarisë se shoqërisë dhe t'ia paraqesë asambleses se ortakeve për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël/kontablin e miratuar dhe anëtare te komisionit te likuidimit si dhe te paraqese propozimet për miratim para ortakeve.
- l. Te siguroje zbatimin e përpikte te Vendimeve te Ortakeve.
- m. Te kryeje çdo detyre tjetër qe i ngarkohet nga ortakët e shoqerise.

NENI 15

EKSPERTI KONTABEL/KONTABILISTI I MIRATUAR

- 15.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël/kontabilist i miratuar për çdo viti financiar. Caktimi i tyre e bën administratori.
- 15.2 Eksperti kontabël/kontabilisti i miratuar mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit te shoqërisë.
- 15.3 Ato përgjigjen për demet qe i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.
- 15.4 Eksperti kontabël / kontabilisti i miratuar mund te shkarkohet sipas mënyrës se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

KREU III

MARRËDHËNIET E PUNES

NENI 16

Marrëdhëniet e punës ne shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave te punës. Për çështjet qe kjo kontrate nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 17

Për çdo mos marrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 18 - Sekret i punës

Te gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

KAPITULLI I IV VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 19 - Viti financiar

- 19.1 Vitit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.
- 19.2 Përjashtimisht Viti i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor të një viti.
- 19.3 Shoqëria “PERELTO Stone Quarry” sh.p.k. cakton Ekspert Kontabël/Kontabël të miratuar për çdo vit financiar.

NENI 20 - Inventari dhe llogarite vjetore

- 20.1 Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore.
- 20.2 Në mbylljen e vitit financiar administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogarite vjetore për vitin financiar.

NENI 21 - Raportet vjetore

- 21.1 Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti harton inventarët dhe llogarite vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortakët.
- 21.2 Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.
- 21.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël/ kontabilisti i miratuar të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 22 - Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme

- 22.1 Nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar pasi zbriten humbet e vitit të mëparshëm, hiqet menjëherë një shumë e barabartë me 5 % (pese përqind) e fitimit të destinuar për formimin e fondit rezerve të quajtur “rezerve e domosdoshme”.
- 22.2 Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur kjo rezerva arrijë 10% të kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 10% e kapitalit.
- 22.3 Ortakët mund të vendosin edhe zbritje të veçante në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shlyerjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

NENI 23

Te ardhurat eventualisht të ndjekura nga shoqëria çdo vit financiar janë të destinuara siç është vendosur nga ortakët duke i qëndruar në uljen 5% që do të destinohet rezervës ligjore.

KAPITULLI V
MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI
NENI 24

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 25

- 25.1 Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuidator, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e sipër".
- 25.2 Likuidatori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vënë në dispozicion menjëherë ortakëve.
- 25.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 26

- 26.1 Ortakët vendosin mbi rregullshmërinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuidatorit.
- 26.2 Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuidatori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakëve ose të një mandat mbajtësi të caktuar prej tij.

NENI 27

- 27.1 Kur ortakët për shkak të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.
- 27.2 Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqëria c' regjistrohet prej tij.

DISPOZITET KALIMTARE

NENI 28 - Dispozitat e fundit

- 28.1 Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet.
- 28.2 Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet.
- 28.3 Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.

NENI 29 - Gjykata kompetente

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve dhe interpretimin e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane.

NENI 30 - Hyrja në fuqi

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortakët.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE
"PERELTO Stone Quarry" sh.p.k.

Dashmor BYCI



Ujkan BYCI



Faton HAKAJ

7



Taulant METOHU



Fatmir HAKAJ

